



Njësia i Prokurimit

Istog: datë, 18.04.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Istogut, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.04.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik NNP "TONI", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"LOTO 2 - MIREMBAJTJA E NDRICIMIT PUBLIK."**, me Nr. të Prok: 633-19-426-2-2-1 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik NNP "TONI", të dt. 13.04.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"LOTO 2 - MIREMBAJTJA E NDRICIMIT PUBLIK."**, me Nr. 633-19-426-2-2-1 Nr. Brendshëm 633-019-005-221, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK –së, të datës 10.04.2019 të publikuar në web-faqe të E-prokurimit.
2. *Vërtetohet* vendimi i AK i publikuar me datë: 10.04.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik NNP "TONI", me datë 13.04.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"LOTO 2 - MIREMBAJTJA E NDRICIMIT PUBLIK."**, me Nr. të Prok: 633-19-426-2-2-1; me Nr. te brendshem te prokurimit: 633-019-005-221. Autoriteti Kontraktues, me datë **18.04.2019**, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Ne Dosjen e tenderit dhe ne Njoftimin per kontrate tek Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale(pika 9.1&9.2), Kapaciteti teknik dhe profesionale-eshte kerkuar:

Per LOTO 2

Kërkesa 3 Stafit profesional

1. Një Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Elektroteknike ose master me përvojë pune minimumi 3 vite pas diplomimit;

Per Loto2

Dëshmia 3 Lista e stafit profesional te paraqitet origjinal e nenshkruar dhe e vulosur.

Per inxhinierin duhet te prezentohet:

- Diploma (e noterizuar origjinale pas publikimit te njoftimit per kontrate);
- Cv-in (origjinal + të nënshkruar nga vetë pala);
- Referenca ne sherbime te ngjashme
- Kontrata valide pune tek operatori ekonomik si staf i rregullt profesional ose Para-kontrata e punës per projektin ne fjale për stafin profesional qe nuk jane staf i operatorit ekonomik ;
- Nje deklarate me shkrim per caktimin e menaxherit te projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për inxhinierin.

Ju si operator konkurues ne kete aktivitet keni ofruar nje diplome e cila nuk eshte e noterizuar pas publikimit te njoftimit per kontrate-e cila eshte kerkese ne dosjen e tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit